

KËRKESË

Nr. 5212/5, datë 14.12.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajjtshme, të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkues është Bashkia e Skraparit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, që do të shpronësohen nga “Zgjerimi i varrezave publike”, në Bashkinë e Skraparit është 1 592 000 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista e emërrore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të shpronësimit, që do të përdoret për "Zgjerimin e varrezave publike", në Bashkinë e Skraparit

Nr	Emri Mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja m ² truall	Çmimi në lek/m2	Vlera në lek	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Selam Teki Koprencka	55/50	1420	1000 m ²	796	796 000	Certifikatë për vërtetim pronësie
2	Hektor Teki Koprencka	55/48	1420	1000 m ²	796	796 000	Certifikatë për vërtetim pronësie
	Totali					1 592 000	